

## **Përmbledhje e projektit: “Përmirësimi i transparencës dhe llogaridhënies në gjykata: Një vlerësim i përputhshmërisë me standardet e transparencës”**

### *Qëllimi i projektit*

Ky projekt synon të rrisë transparencën dhe llogaridhënien në gjykata, duke trajtuar sfidat ekzistuese dhe duke krijuar mekanizma të qëndrueshëm për mbikëqyrje dhe akses në informacion.

### *Objektivat kryesore*

- Hartimi, dhe përgatitja e një Vlerësimi të Përputhshmërisë me Standardet e Transparencës në Gjykata, për të vlerësuar dhe krahasuar nivelin e përputhshmërisë së gjykatave me standardet e transparencës.
- Fuqizimi i mekanizmave të mbikëqyrjes dhe llogaridhënies, duke u ofruar organeve mbikëqyrëse analiza të bazuara në të dhëna për të rritur llogaridhënien dhe për të mbështetur një transparencë të qëndrueshme.
- Forcimi i besimit të publikut te sistemi gjyqësor, duke adresuar mangësitë në transparencë për të nxitur paanshmërinë dhe për të reduktuar ndikimet e jashtme.

### *Grupet e synuara*

- Institucionet qeverisëse të sistemit gjyqësor si Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ), por edhe Kuvendi, për të forcuar standardet e transparencës dhe mekanizmat e mbikëqyrjes.
- Administratorët e faqeve të gjykatave dhe stafi mbështetës, për të përmirësuar publikimin e të dhënave dhe aksesin e qytetarëve në informacion.
- Gjyqtarët për median, nëpunësit e komunikimit dhe koordinatorët për të drejtën e informimit, për të siguruar një komunikim më efektiv dhe trajtim të duhur të kërkesave publike.
- Shoqëria civile, studiuesit dhe vendimmarrësit, të cilët përfitojnë nga akses më i lehtë në të dhëna për avokim dhe analiza.

### *Rezultatet e pritshme*

- Zbatimi i standardeve të transparencës nga gjykatat, duke përmirësuar aksesin në informacion dhe ndërgjegjësimin e aktorëve të ndryshëm.
- Fuqizimi i mbikëqyrjes institucionale, duke mundësuar një monitorim më efektiv të transparencës nga institucionet përkatëse (gjykatat).
- Angazhim më i madh i publikut, duke e kthyer transparencën gjyqësore në një çështje të rëndësishme publike përmes diskutimeve dhe fushatave mediatike.

### *Ndikimet afatgjata*

- Praktika të institucionalizuara të transparencës në funksionimin e përditshëm të gjykatave, duke siguruar qëndrueshmëri dhe përmirësime të vazhdueshme.
- Besim më i lartë i publikut te gjyqësori, përmes forcimit të llogaridhënies dhe hapjes institucionale.
- Potencial për zgjerim dhe përsëritje, duke e kthyer këtë model në një shembull për përmirësime të mëtejshme në sistemin gjyqësor dhe qeverisje.

### *Aktivitetet kryesore*

1. Hulumenti dhe zhvillimi i një Vlerësimi të Përputhshmërisë me Standardet e Transparencës (Muajt 1-5).
2. Diskutime me grupet e interesit për mbledhjen e mendimeve dhe sugjerimeve (Muajt 3-6).
3. Tryezë e rrumbullakët për prezantimin e gjetjeve dhe finalizimin e rekomandimeve (Muaji 8).
4. Hartimi i Udhëzuesit për Mbikëqyrjen Gjyqësore për të ndihmuar institucionet mbikëqyrëse (Muajt 5-8).
5. Fushata e ndërgjegjësimit publik dhe angazhimit në rrjetet sociale, për të informuar dhe përfshirë qytetarët (Muajt 6-9).

### *Produktet kryesore*

1. Vlerësimi i Përputhshmërisë me Standardet e Transparencës në Gjykata: Instrument për matjen e transparencës gjyqësore me analiza të detajuara dhe rekomandime.
2. Raporti i Konsultimeve me Grupet e Interesit: Përmbledhje e diskutimeve dhe sugjerimeve të aktorëve kryesorë për transparencën.
3. Udhëzuesi për Mbikëqyrjen Gjyqësore: Dokument praktik që përcakton përgjegjësitë dhe standardet e monitorimit të gjykatave.
4. Raporti mbi gjetjet dhe rekomandimet nga tryeza e diskutimit: Përmbledhje e sfidave dhe sugjerimeve për forcimin e transparencës gjyqësore.
5. Fushata mediatike dhe ndërgjegjësuese: Strategji për të informuar dhe angazhuar publikun për transparencën në gjykata.

### *Qëndrueshmëria dhe përsëritshmëria*

- Standardizimi i transparencës: Krijimi i një modeli të qartë për matjen dhe monitorimin e transparencës gjyqësore.
- Zbatimi në shkallë më të gjerë: Mjetet e krijuara mund të aplikohen në më shumë gjykata dhe institucione.
- Përvetësim institucional: KLGJ do të luajë një rol kyç në ruajtjen e praktikave të transparencës.
- Fleksibilitet për të adresuar sfida të reja: Struktura e projektit mund të përshtatet me nevojat e ndryshueshme.
- Model për reforma të mëtejshme: Eksperiencat dhe mjetet e zhvilluara mund të shërbejnë si referencë për përmirësime të mëtejshme në qeverisje dhe mbikëqyrje.

**Project summary: “Advancing court transparency and accountability in Albania: An assessment of compliance with transparency standards”**

*Project objective*

This project aims to strengthen transparency and accountability within Albania’s judicial system by addressing existing challenges and establishing sustainable mechanisms for oversight and public access to information.

*Key objectives*

1. To design, develop and produce a Court Transparency Compliance Scorecard to evaluate and compare court adherence to transparency standards.
2. To empower oversight and accountability by providing oversight bodies with data-driven insights to hold judicial institutions accountable and support sustained transparency.
3. To strengthen public trust in the judiciary by addressing transparency gaps to promote impartiality and reduce undue influence.

*Target groups*

- Governing institutions of the judicial system, such as the High Judicial Council (HJC), including the Parliament, to strengthen transparency standards and monitoring mechanisms.
- Court website administrators and judicial support staff, to improve data accessibility and publication.
- Media judges, PR officers, and Right to Information coordinators, to ensure better communication with the public and efficient handling of information requests.
- Civil society, researchers, and policymakers, who will benefit from improved access to reliable data for advocacy and policy analysis.

*Expected results*

- Implementation of transparency standards by courts, improving access to information and raising awareness among judicial actors.
- Strengthened institutional oversight, enabling more effective monitoring of judicial transparency.
- Greater public engagement, turning judicial transparency into a key public issue through discussions and media outreach.

*Long-term impacts*

- Institutionalized transparency practices, integrating transparency frameworks into court operations for sustainability.
- Improved public trust in the judiciary, reinforcing accountability and institutional openness.
- Potential for replication, allowing the developed tools to serve as models for broader judicial and governance reforms.

### *Key activities*

1. Research and development of the Court Transparency Compliance Scorecard (Months 1-5).
2. Stakeholder discussions and focus groups to gather insights and feedback (Months 3-6).
3. Final roundtable discussion to present findings and finalize recommendations (Month 8).
4. Development of the Judicial Oversight Handbook to support oversight institutions (Months 5-8).
5. Public awareness and media engagement campaign, including Q&A sessions and social media outreach (Months 6-9).

### *Key deliverables*

1. Court Transparency Compliance Scorecard: A structured assessment tool providing a detailed analysis of court transparency levels and recommendations.
2. Stakeholder Consultation Report: A summary of key insights from discussions with judicial actors and oversight institutions, integrating their feedback into transparency tools.
3. Judicial Oversight Handbook: A practical guide defining oversight responsibilities, evaluation metrics, and best practices for judicial transparency and accountability.
4. Roundtable Findings and Recommendations Report: A comprehensive summary of discussions with judicial representatives and oversight bodies, outlining challenges and proposed solutions.
5. Public Awareness and Engagement Campaign: A media strategy designed to educate and involve citizens through Q&A sessions, infographics, and social media content.

### *Sustainability and scalability*

- Transparency benchmark: Establishing a standardized framework for judicial transparency assessment and compliance.
- Scalable tools: Developed instruments can be applied to additional courts and institutions, ensuring broader implementation.
- Institutional ownership: The HJC plays a central role in sustaining and institutionalizing transparency practices.
- Continuous engagement: The project structure allows for adaptation to emerging needs and challenges in judicial oversight.
- Judicial integration: Strengthening transparency enhances public trust and accountability within the judiciary.
- Future replication: The transparency models and tools can be expanded to other governance and oversight institutions.